



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 9 mars 2026, Paneli i Gjykatës Supreme, i përbërë prej gjykatësve Ekaterina Trendafilova (Kryegjykatëse), Kristinë van den Vajngart dhe Daniel Fransen, rrëzoi në tërësi kërkesën e Pjetër Shalës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Kërkesa pretendonte disa shkelje në lidhje me Aktgjykimin e Apelit të lëshuar në korrik 2025. Paneli rrëzoi të gjitha pikat e ngritura prej Mbrojtjes dhe nuk konstatoi shkelje të së drejtës së z. Shala për gjykim të drejtë, të së drejtës penale apo të procedurave dhe i shpalli disa pika si të papranueshme.

Ndër të tjera, z. Shala parashtroi se koha prej 24 vitesh mes ngjarjeve dhe gjykimit të tij e bënte shumë të vështirë realizimin e së drejtës për gjykim të drejtë. Duke rikujtuar se në bazë të Kodit Penal të Kosovës nuk ka parashkrim për krimet e luftës, gjykatësit vunë në pah se si u zbatuan një sërë garancish në çështjen e z. Shala për të siguruar drejtësi në vlerësimin e provave.

Për kujtesë: në korrik 2024, Trupi Gjykses e shpalli z. Shala fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme. Z. Shala e apeloj Aktgjykimin dhe, në Aktgjykimin e korrikut 2025, Paneli i Apelit konfirmoi vendimin e fajësisë së tij, por uli dënimin e njësuar nga 18 në 13 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.

Kjo u bë pjesërisht sepse për disa prej viktimave Prokuroria nuk i paraqiti provat përmes një dëshmitari të cilin Mbrojtja mund ta pyeste në gjykatë. Kjo është e rëndësishme, sepse në bazë të Rregullores së DHSK-së, vendimi i fajësisë nuk mund të mbështetet vetëm, ose në masë vendimtare, në deklaratën e një dëshmitari të cilit Mbrojtja nuk ka pasur mundësi t'i bëjë pyetje. Po ashtu, Paneli i Apelit mori parasysh shkallëzimet e dënimeve të zbatueshme në kohën kur u kryen krimet në Kosovë dhe një sërë faktorësh të tjerë dhe doli në përfundimin se dënimi me 13 vjet ishte dënim më i përshtatshëm në këtë çështje.

Për më shumë kontekst: kjo çështje gjyqësore lidhet me krime lufte që u kryen në maj dhe qershor 1999 në fabrikën e metalit në Kukës (FMK), një fabrikë e mëparshme e përpunimit të metaleve në qytetin e Kukësit, në veri të Shqipërisë. Gjatë kësaj kohe, FMK-ja shërbente si shtab i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Kukës dhe u përdor për disa qëllime, ndër të cilat rekrutim, mobilizim dhe logistikë.

Trupi Gjykses konstatoi se ajo u përdor nga disa anëtarë të UÇK-së për të ndaluar, marrë në pyetje dhe keqtrajtuar personat që konsideroheshin se bashkëpunonin, ishin të lidhur, ose simpatizonin autoritetet serbe, ose se nuk mbështesnin mjaftueshëm luftën e UÇK-së.





Viktimat ishin kryesisht shqiptarë të Kosovës.

Trupi Gjykses konstatoi se të ndaluarit u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe degraduese, u morën në pyetje ashpërisht dhe u detyruan të jepnin deklarata dhe të pranonin fajësinë. Sipas Aktgjykimit, ata u keqtrajtuan psikologjikisht dhe fizikisht dhe keqtrajtimi brutal i la të ndaluarit me pasoja afatgjata fizike dhe mendore. Trupi Gjykses konstatoi se një prej të ndaluarve u qëllua me armë nga një anëtar i UÇK-së, pasi ishte keqtrajtuar disa herë nga një grup anëtarësh të UÇK-së. Ai vdiq si pasojë e plagëve të shkaktuara me armë zjarri, ndërthurur me refuzimin e trajtimit të duhur mjekësor.

Në maj/qershor 1999, z. Shala ishte anëtar i UÇK-së. Trupi Gjykses konstatoi se ai ishte i pranishëm fizikisht në FMK në disa raste dhe, bashkë me anëtarë të tjerë të UÇK-së, mori pjesë në marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin brutal të disa prej të ndaluarve. Sipas Aktgjykimit, ai mori pjesë gjithashtu në keqtrajtimin brutal të të ndaluarit që vdiq pasi u qëllua me armë zjarri.

Trupi Gjykses u akordoi dëmshpërblim tetë viktimave pjesëmarrëse në proces dhe urdhëroi z. Shala të paguajë shumën prej 208,000 eurosh si kompensim për dëmin fizik, mendor dhe material që pësuan viktimat.

